

varrosur në fshatin Meqe/Meće.

**Burimet:** deklarata M.K, FDH-29032; FHP, *Haški tribunal, Sudenje Slobodanu Miloševiću*, III, 119-120; KMDLNJ, *Buletini*, num.9, tetor-dhjetor 1998, 137, FDH-23857; SMIP, *Teroristički...*, III, 912; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; KMKMRF, *Personat...*, FDH-10832.

### Pjetër (Tal) Krasniqi

(30.06.1935, shqiptar nga fshati Meqe/Meće, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, tetë fëmijë)

Pjetri e kishte fituar pensionin duke punuar në fabrikën e lëngjeve *Ereniku* në Gjakovë/Đakovica, ku ka punuar si rojë. Me bashkëshorten Gjysten dhe tre djem, një nga të cilët ishte i martuar dhe e kishte një djalë, jetonin në fshatin **Meqe/Meće**. Kur, në mëngjesin e datës **2.08.1998**, forcat serbe e sulmuan fshatin dhe mbi të hodhën predha të para, familja e Pjetrit e braktisi shtëpinë e vet dhe shkoi në drejtim të pyllit ndërmjet fshatrave Čermjan/Crmjane dhe Meqe/Meće. Pjetri nuk deshë të largohet nga shtëpia. U tha familjarëve se do të vinte shpejt pas tyre. Ishte kjo hera e fundit që ata e shihnin të gjallë. Në mbrëmje, familjarët kanë mësuar nga i afërmi, Mark Krasniqi, se Pjetrin e kishin vrarë në oborr [**Meqe/Meće**] dhe se pjesëtarë të forcave serbe e kishin varrosur trupin e tij në varrezat e Gjakovës/Đakovica. Familjarët i kanë zhvendosur mbetjet e tij mortore në varrezat e Doblbarës/Doblbare, më 20.09.1998. U rivarros përfundimisht në fshatin Meqe/Meće, më 2.08.2006.

**Burimi:** deklarata G.K, FDH-29031.

### Nekë (Halit) Pajaziti

(25.04.1942, shqiptar nga Dobroshi/Dobroš, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, gjashtë fëmijë)

Deri në fund të korrikut të vitit 1998, Nekë Pajaziti me bashkëshorten Zelfijen, djemtë dhe vajzat jetonin në fshatin Dobrosh/Dobroš. Kur forcat serbe nisën ta vendosnin rrethimin e fshatit, ai e ka zhvendosur familjen në Gjakovë/Đakovica dhe e ka strehuar te familja Saneja. Po atë ditë, ai u kthye në fshat për disa gjësende. Pas kësaj date, nuk e kanë parë të gjallë kurrë më. Në

datën 5.08.1998, një kushërre e Pajazitëve u ka treguar se nga i afërmi i saj, Qerimi, ka dëgjuar se forcat serbe e kanë vrarë Nekën më **2.08.1998** në **Mejë/Meja**. Po atë ditë, Zelfija shkoi në Gjakovë/Đakovica dhe në ndërmarrjen komunale *Çabrat/Čabrat* ka mësuar se Nekën e kanë varrosur në varrezat e qytetit në Gjakovë/Đakovica. Një punëtor i ndërmarrjes ia ka treguar varrin e Nekës. Familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Nekës në varrezat e fshatit Dobrosh/Dobroš, në vitin 2000.

**Burimi:** deklarata A.P, FDH-15528.

### Ukë (Tahir) Rexha

(1920, shqiptar nga Nivokazi/Nivokaz, komuna e Gjakovës/Đakovica, bujk, dy fëmijë)

Uka i moshuar jetonte në Nivokaz, së bashku me bashkëshorten Nurijen, djalin Brahimin, të rejën Ruken dhe nëntë nipër. Në datën **2.08.1998**, nga ora 17:00, afro tridhjetë policë kanë ardhur te shtëpia e tyre dhe u urdhëruar të gjithë familjarëve që të largoheshin nga shtëpia. Që të gjithë e braktisën shtëpinë dhe u strehuan në fshatin fqinj të Skivjanit/Skivjane, përpos Ukës. Ishte kjo hera e fundit kur familjarët e shihnin të gjallë. Dhjetë ditë më vonë, Nurija u kthye me mbesën Rukmonen në **Nivokaz**, për të mësuar fatin e Ukës. Në oborr i gjetën disa nga rrobat e tij, ndërsa në fushën e afërme edhe trupin e pajetë të Ukës. Trupin e kishte të mavijosur nga keqtrajtimi fizik. Me ndihmën e komshut Adem Osmanit, Nurija e ka varrosur Ukën në varrezat e Nivokazit/Nivokaz, më 13.08.1998.

**Burimi:** deklarata B.R, FDH-15934.

### Nemanja (Hadri) Livić

(25.11.1979, serb nga Beogradi, pjesëtar i UJ-së)

Në vitin 1998, Nemanja ka shkuar në shërbimin e rregullt ushtarak. Ishte pjesëtar i Batalionit të 52 të Policisë Ushtarake. U vra më **2.08.1998**, gjatë përleshjeve me pjesëtarë të UÇK-së në vendin e quajtur *Suka e Radoniqit/Radonjička suka*, te *Liçeni i Radoniqit/Radonjičko jezero*. U varros në Beograd.